



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1769/ 13 prot.

Datë 22/08/2024

V E N D I M
Nr. 1104/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22/08/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 1015/2024, datë 09.08.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-01614-04-16-2024, me objekt: “Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë”, me fond limit 76.338.689,55lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK me NIPT: K61625001I dhe me adresë: Rruga “Dervish Hekali”, Ndërtesa nr. 8, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë SH.A
Adresa: Rajoni Nr. 1, Rruga “Boris Plumbi”, Nr. 20 Korçë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK me NIPT: J91915001P dhe me adresë: Rruga “Abdi Toptani”, Qendra “Torre Drin”, apartamenti 112, kati 11, Tiranë.

Operatori ekonomik “XHENGO” SHPK me NIPT: J64103171M dhe me adresë: DON. GJON. BUZUKU, L.5, Korçë.

Operatori ekonomik “NDERTUESI 2014” SHPK me NIPT: L46827004L dhe me adresë: Rruga “Daut Boriçi”, zona kadastrale nr. 8594, numri i pasurisë 3/574+2-22, volumni 36, faqe 14, Shkodër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi atë në tërësi,

V ë r e n:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 09.08.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1015/2024, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-01614-04-16-2024, me objekt: “Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë”, me fond limit 76.338.689,55lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-01614-04-16-2024, me objekt: “Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë”, me fond limit 76.338.689,55lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.
3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit, duke skualifikuar operatorin ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, në zbatim të pikës 1 të dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
4. Të konstatoj absolutisht të pavlefshëm pikën 4 të dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës të datës 11.07.2024 për anulimin e procedurës, të marrë në

kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

5. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
6. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "ED KONSTRUKSION" SHPK.*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Në datën 14.08.2024 dhe në datën 21.08.2024, janë protokolluar përkatësisht në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1769/9 prot, dhe me nr. 1769/10 prot, shkresat e autoritetit kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A, nr. 246/54 prot., datë 07.08.2024 dhe nr. 249/60 prot, datë 19.08.2024. Nëpërmjet shkresës nr. 249/60 prot, datë 19.08.2024, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se me vendimin nr. 3, datë 19.08.2024 të komisionit të vlerësimit të ofertave ka vendosur lidhur me zbatimin e vendimit nr. 1015/2024, datë 09.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, si më poshtë vijon:

"...

VENDOS

1. Zbatimin e vendimit të KPP Nr. 1015/2024 Nr. 1769/ 7 prot, datë 09/08/2024, duke skualifikuar operatorin ekonomik "ALMO KONSTRUKSION" sh.p.k, në zbatim të pikës 1 të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës Nr. 246/53 prot, 11.07.2024, si dhe pikës 3 të dispozitivit të Vendimit të KPP Nr. 1015/2024.

Sipas pikës 1 të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës Nr. 246/53 prot, 11.07.2024, si dhe arsyetimeve lidhur me këtë pikë tek faqja 5 e vendimit, përcaktohet se, citojmë:

" ... lidhur me punimet e mëparshme të ngjashme "ALMO KONSTRUKSION" Sh.p.k, rezulton që nuk ka paraqitur eksperiencën për zërat e pus-shpimit të preventivit.

Operatori ekonomik ankohet për mangësi në përvojën e mëparshme të ngjashme. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se "Almo Konstruksion" ka paraqitur një kontratë të lidhur me Bashkinë Pukë (ne rolin e AK), ku vlera pa TVSH ka qënë 77 215 481 lek. Nga ana formale janë plotësuar të gjitha kërkesat për paraqitjen e dokumentacionit për punë të ngjashme me një ent shetëror ku janë dorëzuar:

- *Vërtetimi i realizimit të kontratës nënshkruar nga AK, kontrata, situacioni përfundimtar, procesverbal kolaudimi, marrje e përkohshme në dorëzim, dhe FTSH. Gjithashtu rezulton se ALMO Konstruksion ka qënë pjesë e BOE sipas kontratës nr. 8018 rep, 3230 kol datë 13.12.2019 ku kjo shoqëri ka pasur 49.56% të vlerës së punimeve dhe ka përcaktuar punimet që do të marrë përsipër si linja e dërgimit të ujësjellësit depo Pukë dhe linja e brendshme e ujësjellësit. Bazuar në llogaritjen e pjesëmarrjes në këtë BOE dhe zërat e përcaktuar rezulton se Almo Konstruksion ka kryer punime në vlerën 38 267 992 leke pa TVSH, çka detyrimisht plotëson vlerën e kërkuar nga ana jonë si AK për punime të ngjashme në një kontratë të vetme sa 50% e*

fondit limit. Në këto kushte kjo kontratë plotëson kriterin e vlerës dhe ngjashmërisë së punimeve.

- *Ankuesi pretendon se nuk ka punime të ngjashme apo të njëjta sipas preventivit dhe përcakton zëra si hapje pusi, rehabilitim segmentesh rrugore etj. Në lidhje me pretendimin e punimeve për pus, pavarësisht se OE disponon pikën NS 20-A nuk ka arritur të paraqesë punime për zërat e preventivit pus-shpim. Duhet që OE të paraqesë eksperiencën për të gjitha zërat e preventivit përfshirë edhe pus-shpime.*

2. Në zbatim të pikës 3 të dispozitivit të Vendimit të KPP Nr. 1015/2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave arsyeton dhe vendos se në vijim duhet ndjekur i njëjti standart për vlerësimin e punimeve të mëparshme të ngjashme për të gjithë ofertuesit e kualifikuar. Për këtë arsye KVO konstaton se vetë ofertuesi "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë punime për zërat e preventivit pus-shpim dhe për të njëjtën arsye "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k duhet të skualifikohet. Konkretisht "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k ka paraqitur një Kontratë me objekt: "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Libohovë, me vlerë 78.217.634 leke pa TVSH sipas % të pjesëmarrjes, viti 2020-2022, së bashku me preventivat dhe dokumentat përkatëse të realizimit.

Si dhe një Kontratë me objekt për Ndërtimin e ujësjellësit Sinice, Çete, Miras ..., me vlerë 105.105.504,94 leke pa TVSH sipas % të pjesëmarrjes, viti 2020-2023, së bashku me preventivat dhe dokumentat përkatëse të realizimit.

Tek të dyja këto kontrata konstatojmë që ka zëra punimesh ujësjellës, depo, puseta shuarje, gërmime, punime b/a etj, por nuk ka punime për pus-shpim.

Duhet që OE të paraqesë eksperiencën për të gjitha zërat e preventivit përfshirë edhe pus-shpime dhe për këtë arsye skualifikohet.

3. Në zbatim të pikës 3 të dispozitivit të Vendimit të KPP Nr. 1015/2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave arsyeton dhe vendos se në vijim duhet ndjekur i njëjti standart për vlerësimin e punimeve të mëparshme të ngjashme për të gjithë ofertuesit e kualifikuar. Për këtë arsye KVO konstaton se ofertuesi "NIEM" Sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë punime për zërat e preventivit pus-shpim dhe për të njëjtën arsye "NIEM" Sh.p.k duhet të skualifikohet.

Konkretisht "NIEM" Sh.p.k ka paraqitur një Kontratë me objekt për Ndërtimin e ujësjellësit Sinice, Çete, Miras ..., me vlerë 52.552.752,47 leke pa TVSH sipas % të pjesëmarrjes viti 2020-2023, së bashku me preventivat dhe dokumentat përkatëse të realizimit. Tek kjo kontratë konstatojmë që ka zëra punimesh ujësjellës, depo, puseta shuarje, gërmime, punime b/a etj, por nuk ka punime për pus-shpim. Duhet që OE të paraqesë eksperiencën për të gjitha zërat e preventivit përfshirë edhe pus-shpime dhe për këtë arsye skualifikohet.

4. Klasifikimi i ofertave, të tenderit "Procedurë e hapur" , me objekt: "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë", REF-01614-04-16-2024, fond limit 76338689,55 leke pa TVSH është si më poshtë:

Në vend të parë "ASI-2A CO" Sh.p.k, NIPT: K53002402C, vlera: 61598522,3 (gjashtëdhjetë e një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e pesëqind e njëzet e dy presje tre) leke.

Në vend të dytë BOE "Infinit" Shpk NIPT: J74304623M & "VIANTE Konstruksion" Shp, NIPT: K47103804L & "Mikael-Grup" Shpk, NIPT: K64108001G, vlera: 7184111,582 (gjashtëdhjetë e shtatëmilion e njëqind e tetëdhjetë e katërmijë e njëqind e njëmbëdhjetë presje pesëqind e tetëdhjet e e dy) leke.

Skualifikimi pasqyrohet në SPE nëpërmjet rivlerësimit dhe pasi të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përfundojnë procesin e rivlerësimit në SPE, sistemi tregon "Renditjen përfundimtare" të ofertuesve- Shih dokumentin bashkangjitur .

Ky Vendim në formë shkresore i vihet në dispozicion Njesisë së Prokurimit dhe njoftimi i klasifikimit dërgohet tek ofertuesit pjesëmarrës.

Në rastin e prokurimit me mjete elektronike, sistemi administron automatikisht të dhënat, vlerësimet dhe komentet mbi to, duke njoftuar, në rrugë elektronike, ofertuesit.”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Në datën 14.08.2024 dhe në datën 21.08.2024, janë protokolluar përkatësisht në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1769/9 prot, dhe me nr. 1769/10 prot, shkresat e autoritetit kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A, nr. 246/54 prot., datë 07.08.2024 dhe nr. 249/60 prot, datë 19.08.2024. Nëpërmjet shkresës nr. 249/60 prot, datë 19.08.2024, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se me vendimin nr. 3, datë 19.08.2024 të komisionit të vlerësimit të ofertave ka vendosur lidhur me zbatimin e vendimit nr. 1015/2024, datë 09.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, si më poshtë vijon:

“...VENDOS

1. Zbatimin e vendimit të KPP Nr. 1015/2024 Nr. 1769/ 7 prot, datë 09/08/2024, duke skualifikuar operatorin ekonomik "ALMO KONSTRUKSION" sh.p.k, në zbatim të pikës 1 të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës Nr. 246/53 prot, 11.07.2024, si dhe pikës 3 të dispozitivit të Vendimit të KPP Nr. 1015/2024.

Sipas pikës 1 të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës Nr. 246/53 prot, 11.07.2024, si dhe arsytiveve lidhur me këtë pikë tek faqja 5 e vendimit, përcaktohet se, citojmë:

" ... lidhur me punimet e mëparshme të ngjashme "ALMO KONSTRUKSION" Sh.p.k, rezulton që nuk ka paraqitur eksperiencë për zërat e pus-shpimit të preventivit.

Operatori ekonomik ankohet për mangësi në përvojën e mëparshme të ngjashme. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se "Almo Konstruksion" ka paraqitur një kontratë të lidhur me Bashkinë Pukë (ne rolin e AK), ku vlera pa TVSH ka qënë 77 215 481 lek. Nga ana formale janë plotësuar të gjitha kërkesat për paraqitjen e dokumentacionit për punë të ngjashme me një ent shetëror ku janë dorëzuar:

- Vërtetimi i realizimit të kontratës nënshkruar nga AK, kontrata, situacioni përfundimtar, procesverbal kolaudimi, marrje e përkohshme në dorëzim, dhe FTSH. Gjithashtu rezulton se ALMO Konstruksion ka qënë pjesë e BOE sipas kontratës nr. 8018 rep, 3230 kol datë 13.12.2019 ku kjo shoqëri ka pasur 49.56% të vlerës së punimeve dhe ka përcaktuar punimet që do të marrë përsipër si linja e dërgimit të*

ujësjellësit depo Pukë dhe linja e brendshme e ujësjellësit. Bazuar në llogaritjen e pjesëmarrjes në këtë BOE dhe zërat e përcaktuar rezulton se Almo Konstruksion ka kryer punime në vlerën 38 267 992 leke pa TVSH, çka detyrimisht plotëson vlerën e kërkuar nga ana jonë si AK për punime të ngjashme në një kontratë të vetme sa 50% e fondit limit. Në këto kushte kjo kontratë plotëson kriterin e vlerës dhe ngjashmërisë së punimeve.

- Ankuesi pretendon se nuk ka punime të ngjashme apo të njëjta sipas preventivit dhe përcakton zëra si hapje pusi, rehabilitim segmentesh rrugore etj. Në lidhje me pretendimin e punimeve për pus, pavarësisht se OE disponon pikën NS 20-A nuk ka arritur të paraqesë punime për zërat e preventivit pus-shpim. Duhet që OE të paraqesë eksperiencën për të gjitha zërat e preventivit përfshirë edhe pus-shpime.

2. Në zbatim të pikës 3 të dispozitivit të Vendimit të KPP Nr. 1015/2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave arsyeton dhe vendos se në vijim duhet ndjekur i njëjti standart për vlerësimin e punimeve të mëparshme të ngjashme për të gjithë ofertuesit e kualifikuar. Për këtë arsye KVO konstaton se vetë ofertuesi "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë punime për zërat e preventivit pus-shpim dhe për të njëjtën arsye "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k duhet të skualifikohet. Konkretisht "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k ka paraqitur një Kontratë me objekt: "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Libohovë, me vlerë 78.217.634 leke pa TVSH sipas % të pjesëmarrjes, viti 2020-2022, së bashku me preventivat dhe dokumentat përkatëse të realizimit.

Si dhe një Kontratë me objekt për Ndërtimin e ujësjellësit Sinice, Çete, Miras ..., me vlerë 105.105.504,94 leke pa TVSH sipas % të pjesëmarrjes, viti 2020-2023, së bashku me preventivat dhe dokumentat përkatëse të realizimit.

Tek të dyja këto kontrata konstatojmë që ka zëra punimesh ujësjellës, depo, puseta shuarje, gjurmime, punime b/a etj, por nuk ka punime për pus-shpim.

Duhet që OE të paraqesë eksperiencën për të gjitha zërat e preventivit përfshirë edhe pus-shpime dhe për këtë arsye skualifikohet.

3. Në zbatim të pikës 3 të dispozitivit të Vendimit të KPP Nr. 1015/2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave arsyeton dhe vendos se në vijim duhet ndjekur i njëjti standart për vlerësimin e punimeve të mëparshme të ngjashme për të gjithë ofertuesit e kualifikuar. Për këtë arsye KVO konstaton se ofertuesi "NIEM" Sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë punime për zërat e preventivit pus-shpim dhe për të njëjtën arsye "NIEM" Sh.p.k duhet të skualifikohet.

Konkretisht "NIEM" Sh.p.k ka paraqitur një Kontratë me objekt për Ndërtimin e ujësjellësit Sinice, Çete, Miras ..., me vlerë 52.552.752,47 leke pa TVSH sipas % të pjesëmarrjes viti 2020-2023, së bashku me preventivat dhe dokumentat përkatëse të realizimit. Tek kjo kontratë konstatojmë që ka zëra punimesh ujësjellës, depo, puseta shuarje, gjurmime, punime b/a etj, por nuk ka punime për pus-shpim. Duhet që OE të paraqesë eksperiencën për të gjitha zërat e preventivit përfshirë edhe pus-shpime dhe për këtë arsye skualifikohet.

4. Klasifikimi i ofertave, të tenderit "Procedurë e hapur", me objekt: "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë", REF-01614-04-16-2024, fond limit 76338689,55 leke pa TVSH është si më poshtë:

Në vend të parë "ASI-2A CO" Sh.p.k, NIPT: K53002402C, vlera: 61598522,3 (gjashtëdhjetë e një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet e dy presje tre) leke.

Në vend të dytë BOE "Infinit" Shpk NIPT: J74304623M & "VIANTE Konstruksion" Shp, NIPT: K47103804L & "Mikael-Grup" Shpk, NIPT: K64108001G, vlera: 7184111,582

(gjashtëdhjetë e shtatëmilion e njëqind e tetëdhjetë e katërmijë e njëqind e njëmbëdhjetë presje pesëqind e tetëdhjet e e dy) leke.

Skualifikimi pasqyrohet në SPE nëpërmjet rivlerësimit dhe pasi të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përfundojnë procesin e rivlerësimit në SPE, sistemi tregon "Renditjen përfundimtare" të ofertuesve- Shih dokumentin bashkangjitur .

Ky Vendim në formë shkresore i vihet në dispozicion Njesisë së Prokurimit dhe njoftimi i klasifikimit dërgohet tek ofertuesit pjesëmarrës.

Në rastin e prokurimit me mjete elektronike, sistemi administron automatikisht të dhënat, vlerësimet dhe komentet mbi to, duke njoftuar, në rrugë elektronike, ofertuesit.”.

Komisioni Prokurimit Publik referuar dokumentacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor me shkresën nr. 246/59 prot., datë 19.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 1769/10 prot., datë 21.08.2024, si dhe sistemit elektronik të prokurimeve publike (SPE) të Agjencisë së Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar me korrektësi pikën 3, si dhe nuk ka zbatuar pikën 4, të dispozitivit të vendimit nr. 1015/2024, datë 09.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik sipas përcaktimeve të bëra në to, duke skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK, si dhe duke skualifikuar ofertën e shoqërisë “NIEM” SHPK.

II.2. Autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A njofton se ka zbatuar vendimin nr. 1015/2024, datë 09.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-01614-04-16-2024, me objekt: “Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë”, me fond limit 76.338.689,55lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.

Me shkresën nr. 246/60 prot., datë 19.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 1769/10 prot., datë 21.08.2024, autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A njofton se (citojmë): “... 2. Ne zbatim të pikës 3 të dispozitivit të Vendimit të KPP Nr. 1015/2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave arsyeton dhe vendos se në vijim duhet ndjekur i njëjti standart për vlerësimin e punimeve të mëparshme të ngjashme për të gjithë ofertuesit e kualifikuar. Për këte arsye KVO konstaton se vetë ofertuesi "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë punime për zërat e preventivit pus-shpim dhe për të njëjtën arsye "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k duhet të skualifikohet. Konkretisht "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k ka paraqitur një Kontratë me objekt: “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Libohovë, me vlerë 78.217.634 leke pa TVSH sipas % të pjesëmarrjes, viti 2020-2022, së bashku me preventivat dhe dokumentat përkatëse të realizimit.

Si dhe një Kontratë me objekt për Ndërtimin e ujësjellësit Sinice, Çete, Miras ..., me vlerë 105.105.504,94 leke pa TVSH sipas % të pjesëmarrjes, viti 2020-2023, së bashku me preventivat dhe dokumentat përkatëse të realizimit.

Tek të dyja këto kontrata konstatojmë që ka zëra punimesh ujësjellës, depo, puseta shuarje, gjermime, punime b/a etj, por nuk ka punime për pus-shpim.

Duhet që OE të paraqesë eksperiencë për të gjitha zërat e preventivit përfshirë edhe pus-shpime dhe për këtë arsye skualifikohet.

3. Në zbatim të pikës 3 të dispozitivit të Vendimit të KPP Nr. 1015/2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave arsyeton dhe vendos se në vijim duhet ndjekur i njëjti standart për vlerësimin e punimeve të mëparshme të ngjashme për të gjithë ofertuesit e kualifikuar. Për këtë arsye KVO konstaton se ofertuesi "NIEM" Sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë punime për zërat e preventivit pus-shpim dhe për të njëjtën arsye "NIEM" Sh.p.k duhet të skualifikohet.

Konkretisht " NIEM " Sh.p.k ka paraqitur një Kontratë me objekt për Ndërtimin e ujësjellësit Sinice, Cete, Miras ..., me vlerë 52.552.752,47 leke pa TVSH sipas % të pjesëmarrjes viti 2020-2023, së bashku me preventivat dhe dokumentat përkatëse të realizimit. Tek kjo kontratë konstatojmë që ka zëra punimesh ujësjellës, depo, puseta shuarje, gërmime, punime b/a etj, por nuk ka punime për pus-shpim. Duhet që OE të paraqesë eksperiencë për të gjitha zërat e preventivit përfshirë edhe pus-shpime dhe për këtë arsye skualifikohet.

4. Klasifikimi i ofertave, të tenderit "Procedurë e hapur" , me objekt: "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë", REF-01614-04-16-2024, fond limit 76338689,55 leke pa TVSH është si më poshtë:

Në vend të parë "ASI-2A CO" Sh.p.k, NIPT: K53002402C, vlera: 61598522,3 (gjashtëdhjetë e një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet e dy presje tre) leke.

Në vend të dytë BOE "Infinit" Shpk NIPT: J74304623M & "VIANTE Konstruksion" Shp, NIPT: K47103804L & "Mikael-Grup" Shpk, NIPT: K64108001G, vlera: 7184111,582 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e njëqind e tetëdhjetë e katërmijë e njëqind e njëmbëdhjetë presje pesëqind e tetëdhjet e e dy) leke.”.

Me vendimin nr. 1015/2024, datë 09.08.2024, Komisioni i Prokurimit Publik, ka vendosur rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit dhe konkretisht rivlerësimin vetëm të ofertës së operatorit ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, duke e skualifikuar këtë ofertues, si dhe të konstatojë absolutisht të pavlefshëm pikën 4 të dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës të datës 11.07.2024 për anulimin e procedurës, por nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik referuar informacionit të sipërpërmendur të autoritetit kontraktor dhe nga verifikimet në Sistemin Elektronik të Prokurimit konstaton se pika 3 të dispozitivit të vendimit K.P.P nr. 1015/2024, datë 09.08.2024 është zbatuar nga ana e autoritetit kontraktor në tejkalim të parashikimeve të kësaj pikë, pasi janë skualifikuar edhe oferta e operatorit ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK, dhe oferta e operatorit ekonomik “NIEM” SHPK, të cilët në vlerësimin e datës 10.06.2024 kanë qënë të kualifikuar sikurse është përmendur edhe në pikën II.3, të vendimit të sipërpërmendur të Komisionit të Prokurimit Publik.

Në rastin konkret, nisur nga veprimet e autoritetit kontraktor në lidhje me skualifikimin e operatorëve ekonomikë “ED KONSTRUKSION” SHPK, dhe oferta e operatorit ekonomik “NIEM” SHPK, KPP vëren, se momenti procedural i vlerësimit të dokumentacionit mbi kriteret e kualifikimit, të dorëzuar në SPE, duhet të ishte data 10.06.2024, datë në të cilën referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike rezultojnë të jetë përmbyllur dhe procesi i vlerësimit të ofertave nga ana komisionit të vlerësimit të ofertave. Jo më kot ligjvënësi, në varësi të llojit të procedurës, ka parashikuar një afat kohor (20 ose 15 ditë) për procesin e vlerësimit të ofertave duke dhënë garanci për secilën prej palëve, KVO nga njëra anë për kryerjen e një vlerësimi të thelluar e transparent dhe me mundësinë edhe të kryerjes së verifikimeve pranë palëve të treta ose sqarimeve nga operatorët ekonomikë sa herë lind nevoja, dhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që pas procesit të vlerësimit të ofertave dhe

publikimit të njoftimit të fituesit paraprak apo anulimit të procedurës të kenë mundësi të mbrojnë interesat e ligjshëm duke ushtruar të drejtën e ankimit në autoritet kontraktor dhe në KPP. Në këtë kuadër KPP gjykon, se brenda periudhës kohore që ligji ka parashikuar, KVO e autoritetit kontraktor ka patur në dipozicion momentin procedural për kryerjen e verifikimeve apo sqarimeve të nevojshme për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme apo të veçanta të kualifikimit, derisa të konkludonte me mbylljen e procesit të vlerësimit në sistemin e prokurimit elektronik me datë 10.06.2024, ku operatorët ekonomikë “ED KONSTRUKSION” SHPK, dhe oferta e operatorit ekonomik “NIEM” SHPK rezultojn të kualifikuar, çfarë do të thotë, se sipas vlerësimit të KVO-së së autoriteti kontraktor këta operatorë ekonomikë i kanë përmbushur kriteret për kualifikim. Brenda periudhës kohore (20 apo 15 ditë) që ligjvënësi ka parashikuar, KVO e autoritetit kontraktor ka patur ne dipozicion momentin procedural per kryerjen e verifikimeve apo sqarimeve te nevojshme per permbushjen e kriterëve te pergjithshme apo te veçanta te kualifikimit, derisa te konkludonte me mbylljen e procesit te vleresimit ne sistemin e prokurimit elektronik te dates 10.06.2024, çka do te thote, se sipas vleresimit te KVO-se se autoriteti kontraktor, operatorët ekonomikë të sipërcituar i kanë përmbushur kriteret per kualifikim. Ligjvenesi e ka parashikuar qarte ne nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, qe ne rastin e Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas percaktimit në Nenin 82, te LPP se, dhe ne keto rregulla. Per te vazhduar me piken 6 te VKM-se se sipercituar ku parashikohet se “6. Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njesuara me origjinalin. Vetëm per dokumentet e deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit dhe qe kane sherbyer si prove paraprake, autoriteti kontraktor mund te shprehe vleresimin mbi perputhshmerine e tyre me ate qe operatori ekonomik ankimues ka deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit te ngarkuar ne SPE, ndërsa për kriteret e tjera kualifikuese si në rastin konkrete “Punët e Ngjashme” dhe te gjithë dokumentet e tjera te ngarkuara ne sistemin e prokurimit elektronik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i autoritetit kontraktor, ka patur ne dispozicion momentin procedural te vleresimit te dokumenteve ne SPE deri me date 10.06.2024, moment kur ka perfunduar procesi i vleresimit ne SPE dhe janë njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi vlerësimin e tyre ne lidhje me perputhshmerine e tyre me kriteret per kualifikim te percaktuar ne dokumentet e tenderit. Legjislacioni i Prokurimit Publik e ka përcaktuar në mënyrë të qartë që një ofertë konsiderohet e vlefshme vetëm nëse ajo pëmbush të gjitha kërkesat për kualifikim, fakt të cilin Komisioni Vlerësimit të Ofertave i autoritetit tuaj kontraktor e ka shprehur me vlerësimin e datës 10.06.2024, ku gjëndja faktike dhe juridike e operatorëve ekonomikë “ED KONSTRUKSION” SHPK, dhe “NIEM” SHPK rezulton e kualifikuar. KPP thekson se, se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për t’u ndjekur nga ana e autoriteteve kontraktore në procesin e vlerësimit të ofertave si në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ashtu dhe në Udhëzimin nr. 07, datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, ku përcaktohet se: “Pas

*përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, anëtari i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të bëjë në sistem mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave në sistem. Në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës”. dhe vetëm në rastet e deklarimeve të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE dhe që shërbejnë si provë paraprake vlerësimi, KVO e autoritetit kontraktor me dokumentacionin e dorëzuar në rrugë shkesore mund të verifikojë përputhshmërinë e deklarimeve të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar në rrugë shkresore. Komisioni Prokurimit Publik thekson se veprimet e autoritetit kontraktor janë të gabuara, si zbatimin ashtu dhe interpretimin e ligjit pasi nuk mund të rivleresojë edhe njëhere dokumentet e dorëzuara në rrugë elektronike nga operatorët ekonomik me qëllim verifikimin e përmbushjes së kriterëve për kualifikim, pasi për këtë fakt Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të autoritetit kontraktor është shprehur njëhere me datë 10.06.2024 ku statusi i operatorëve ekonomikë “ED KONSTRUKSION” SHPK, dhe “NIEM” SHPK rezultoi të kualifikuar. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palet të interesuara. Parimi i ligjshmerisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Ndaj KPP gjykon, se skualifikimi i operatorëve ekonomikë “ED KONSTRUKSION” SHPK, dhe “NIEM” SHPK është kryer në shkelje të parashikimeve ligjore dhe i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me momentin procedural të verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në SPE, në shkelje të afateve ligjore.*

Sa më sipër Komisioni Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të rivlerësojë procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kualifikuar ofertat e operatorëve ekonomikë “ED KONSTRUKSION” SHPK dhe “NIEM” SHPK, sipas statutit që kanë patur në datën 10.05.2024, si dhe duke lënë të skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, sipas pikës 3 të dispozitivit të vendimit të K.P.P nr. 1015/2024, datë 09.08.202, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. *REF-01614-04-16-2024*, me objekt: “*Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë*”, me fond limit 76.338.689,55lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SH.A.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kualifikuar ofertat e operatorëve ekonomikë “*ED KONSTRUKSION*” SHPK dhe “*NIEM*” SHPK, sipas statutit që kanë patur në datën 10.05.2024, si dhe duke lënë të skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “*ALMO KONSRUKSION*” SHPK, sipas pikës 3 të dispozitivit të vendimit të K.P.P nr. 1015/2024, datë 09.08.202, të Komisionit të Prokurimit Publik..
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

